Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**11.08.2023**	**22.08.2023**	**2023/0553**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.08.2023, OE “" AS Tech " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0553, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim dhe mirembajtje te klimave ne QKMF dhe njesit e saj” me nr. të prokurimit: "73350-23-6551-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure: Kuotim i Çmimit, lloji i kontrates:, shërbim, vlera e parashikuar e kontrates: 9,999.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë B05: 27.06.2023/ Data e njoftimit për dhënie te kontratë B08: 24.07.2023, Data e njoftimit për anulimin e dhënies se kontratë B11 : 25.07.2023, data e hapjes së ofertës: 10.07.2023, data e njoftimit mbi vendimit e AK: 17.07.2023, data e njoftimit të me letër standarde:17.07.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi

1 . Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Neni 6- Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Ofertuesit duhet të ofrojn dëshmi se ka kontrata apo kontratë të realizuara të natyres së njejtë për periudhën e shkuar tre vjeçare, e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë.Vlera e përgjithëshme monetare për shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00

Lista e kontratave të realizuara së bashku me referenca përkatëse,raporte (deshmi vetem te natyres perkatse Aneksi 1 DT).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm

OE i rekomanduar per kontrate eshte i përgjegjshëm

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" AS Tech " SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues " AS Tech " SH.P.K i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

OE ankues me datën: 17.07.2023, ka pranuar vendimin e AK-se dhe letrën standarde si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa ne ankesën e tij ka pretendim se OE i rekomanduar për kontrate, nuk ka ofruar kontrata te natyrës se njëjtë, sipas kërkesës se dosjes se tenderit, ku AK-ja ka kërkuar:

Ofertuesit duhet të ofrojn dëshmi se ka kontrata apo kontratë të realizuara të natyres së njejtë për periudhën e shkuar tre vjeçare, e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë.Vlera e përgjithëshme monetare për shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ankesën e tij OE ankues i konteston kontratat veq e veq për te cilat pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, nuk e arrin vlerën e kërkuar sipas dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar listën e kontratave vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse me vetëm kontratën me nr. rendor 7, i rekomanduari për kontrate e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit.

Poshtu lidhur me ketë pretendim eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se kantatat e dorëzuara janë me operatore ekonomik privat dhe te njëjtat nuk duhen te merren parasysh, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka bashkangjitur

qarkullimin bankar. Ky pretendon qëndron për faktin se kjo nuk është kërkesë e parapare ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate dhe do te ishte ne kundërshtim me paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-se:

56.3: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

termovision

LISTA E KONTRATAVE

Nr.	Emri i kontrates	Date e fillimit	Date e mbarimit	Vlera	Investitori	Email	Nr. Tel
1	"Upgranding of heating plants in two EULEX locations- LoT 1"	09.06.2019	09.06.2020	€ 60,659.00	EULEX	purchasing.office@eulex-kosovo.eu	038/28-2000
2	Programi i zbatimit të masave të Efiçiencës së Energjisë-në objektet publike në nivel lokal...	16.09.2019	15.12.2019	€ 129,476.16	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	selami.berisha@rks-gov.net	038/200-215-32
3	Instalimi I ngrohjes qendrore, ventilimit dhe klimatizimit ne Objektin e Policise Kufitare Radavce Peje	16.10.2019	30.11.2019	€ 39,000.00	Ceta-Invest Group	ceta_gjg@hotmail.com	044/232-167
4	" Furnizimi dhe instalimi i sistemit të ujesjellsit dhe kanatizimit ne projektin e 22 shtëpive për banim social nga KK e Podujevës"	16.03.2020	20.06.2020	€ 11,765.00	N.N." Dekor"Podujeve	n.n_dekor-podujeve@hotmail.com	049/170-420
5	Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje të tjera te obligueshme –Programi mbështetës - Zbatimi i Masave të Efiçiencës së Energjisë në Ndërtesat e Shërbimit Publik (VII)	01.08.2020	13.11.2020	€ 379,954.63	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	selami.berisha@rks-gov.net	038/200-215-32
6	Furnizimi, Instalimi dhe mirembajtja e HVAC - Shtepia e te moshuarve - Gjinovc- Suhareke	10.05.2020	11.10.2021	€ 167,500.00	N.N." Dekor"Podujeve	n.n_dekor-podujeve@hotmail.com	049/170-420
7	Supply with materials and installations for Heating, Ventilation, Air/ Conditioning in wastewater treatment plant in Peja	12.11.2020	15.05.2022	€ 42,567.44	Strabag AG Branch Office Kosovo	armendrmaliqi@gmail.com	049/770-272
8	Furnizimi dhe montimi i kalldase per SHML " Dardania - Hani I Elezit"	02.12.2020	09.12.2020	€ 8,840.40	Komuna Hani i Elezit	prokurimi.he@gmail.com	038/200-44-368
9	Replacement of underground heating pipes for the Polish FPU in ECM in Mitrovica	15.02.2021	26.02.2021	€ 39,021.70	EULEX	purchasing.office@eulex-kosovo.eu	038/28-2000
10	Rregullimi i infrastruktures ne QKMF Hani i Elezit (Rregullimi i nxemjes)	18.10.2021	08.07.2022	€ 44,342.50	Komuna Hani i Elezit	prokurimi.he@gmail.com	038/200-44-368
11	Mirembajtja e ngrohjes qendrore ne objektet komunale	12.10.2021	11.10.22	€ 50,000.00	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	038/200-410-22
12	Riparimi kaldajave dhe ngrohjes qendrore ne shkolla	01.11.2021	31.10.2022	€ 21,187.50	Komuna e Gjakoves	faton.gutaj@rks-gov.net	038/200-440-401
13	Pajisje për sistemin e ngrohjes në QMF	06.11.2021	20.12.2021	€ 43,938.31	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	038/200-410-22
14	Renovimi I ngrohjeve qendrore	22.11.2021	08.12.2021	€ 22,567.50	Komuna e Vushtrrise	prokurimi.vushtrri@rks-gov.net	038/200-42-403
15	PUR/035/22 EEPC Separate Heating Plant for Kobe 2 & 3	03.11.2022	05.12.2022	€ 14,966.00	EULEX	purchasing.office@eulex-kosovo.eu	038/28-2000
16	Instalimi rregullimi dhe riparimi kaldajave dhe ngrohjes qendrore ne shkolla	5.09.2022	08.11.2022	€ 45,877.50	Komuna e Gjakoves	faton.gutaj@rks-gov.net	038/200-440-401
17	Mirembajtja e ngrohjes qendrore ne objektet komunale	01.11.2022	Vazhdon	€ 50,000.00	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	038/200-410-22
				1,111,004.64 €			

"TERMOVISION SHPK"
Artist Kurtaj - Drejtor

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" AS Tech " SH.P.K.**

Florije Rexhepi